

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar, Afrim Shala dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit R.K., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale vjedhje pylli, nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1141/15, e datës 6 mars 2018, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, P.nr.445/15, i datës 23 shkurt 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 8 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, P.nr.445/15, i datës 23 shkurt 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.K., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje pylli, nga neni 358 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me kusht, ashtu që ndaj të pandehurit është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i pandehuri në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen vepra tjera penale.

I pandehuri R.K., është liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

Pala e dëmtuar-Drejtoria për Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari në Suharekë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me burgim.

Ndaj ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, përgjigje në ankesë ka paraqitur i pandehuri, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ankesa e paraqitur të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/II.nr.362/2018, të datës 17 prill 2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovet, kurse, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të pandehurit të shqiptohet dënim me burgim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatojë se :

- ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Sa i përket vendimit për dënimin, në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është tejet i butë, ngase janë marrë për bazë vetëm rrethanat lehtësuese. Gjykata e shkallës së parë gjatë matjes së dënimin është dashur që t'i marrë për bazë edhe rrethanat rënduese, siç janë : dashja e kryesit të veprës penale, faktin se veprat penale të vjedhjes së pyllit janë në rritje e sipër si dukuri, vëllimin e përgjithshëm të drunjëve të prerë e cila në rastin konkret është 6 m³ dhe faktin se i akuzuari në këtë kohë ka kryer edhe shumë vepra tjera penale të llojit të njëjtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimi i lartcekur i paraqitur në ankesë për një dënim me burgim është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimin, siç parashihet në nenin 73 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese janë marrë për bazë pranimi i fajësisë; se i pandehuri është penduar dhe është hera e parë që i njëjti ka rëndë ndesh me ligjin, kurse, nuk ka gjetur rrethana rënduese për të pandehurin. Sa i përket pretendimit ankimor, se i pandehuri ka kryer edhe vepra tjera penale, në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren vetëm theksohet një fakt i tillë, mirëpo, nuk vërtetohet me asnjë provë apo kopje të aktgjykimit të formës së prerë, kurse në anën tjetër, dashja e të pandehurit nuk mund të merret si rrethanë rënduese, kjo për faktin se dashja duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 1 të

KPRK, është element i përgjegjesisë penale dhe si rezultat i kësaj është edhe element i veprës penale.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit R.K. është në harmoni me peshën e veprës penale, me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjesisë penale të të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.353/2018, Më 8 maj 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Gani Zabeli

Shqipe Qerimi